


DORACAK PËR MËSIMIN NGA LËNDA ZGJEDHORE

ETIKA NË RELIGJIONE

Snezhana Mirasçieva






БЪРС ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО

DORACAK PËR MËSIMIN NGA LËNDA ZGJEDHORE

ETIKA NË RELIGJIONE

Snezhana Mirasçieva



БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО

Botues:

Byroja e zhvillimit të arsimit

Për botuesin:

Vesna Horvatoviç, *drejtor*

Redaksia:

Ivanka Mijiç, *redaktor përgjegjës*

Ajshe Ajrullai, *anëtar*

Mirjançe Milloshevska, *anëtar*

Recenzentë:

Ilija Leshkovski

Mitko Çeshllarov

Përkthim:

Mivedete Mahmuti

Disejني:

Svetllana Stojçeva

Botoi:

Kiro Dandaro - Manastir

Tirazhi:

150

Shkup, 2010

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Nacionalna i univerzitetska biblioteka Sv. „Kliment Ohridski“, Skopje

373.3.091.241(035)

MIRASÇIEVA, Snezhana

Doracake për lëndën e etikës në religjione / Snezhana Mirasçieva ;

[përkthyes Mivedete Mahmuti], - Shkup : Byroja e zhvillimit të arsimit, 2010. - 29 str. ; 21cm

ISBN 978-608-206-022-4

a) Религиска етика - Основно образование - Наставни методи - Прирачници

COBIS. MK-ID 84446218

Të nderuar mësimdhënës, aplikimi i lëndës mësimore Etika në religjione në arsimin fillor e ka paraqitur nevojën e përpilimit të doracakut për mësimdhënësit e kësaj lëndë mësimore. Qëllimi i këtij doracaku është që t'ju ndihmojë në planifikimin dhe përgatitjen e mësimin sipas kësaj lënde, si dhe për zgjedhjen e aparaturës adekuate didaktike – metodike gjatë realizimit të mësimin në lëndën Etika në religjione. Vlerësojmë se doracaku për nga struktura dhe përmbajtja e tij do të ketë rol të rëndësishëm në etapën preparative, operative dhe verifikuese të mësimin në lëndën etika në religjione.

Përmbajtjet në doracak nuk kanë karakter kufizues dhe direktiv. Përkundrazi ata përqendrohen në drejtim të nxitjes së inicimit, konstruktivizmit, kreativitetit dhe fleksibilitetit të mësimdhënësit. Ata kanë për qëllim që ta iniciojnë lirinë, nxitjen dhe punën krijuese të mësimdhënësit në përgatitjen dhe realizimin e mësimin në lëndën etika në religjione. Doracaku konkretisht paraqet kornizën e mundshme për realizimin e mësimin në lëndën Etika në religjione. Doracaku konkretisht paraqet kornizë të mundshme për realizimin e mësimin në lëndën e caktuar nga nevojat, mundësitë, aftësitë dhe interesat e nxënësve.

Kështu që në doracak është propozuar dhe ofruar struktura e orës mësimore. Struktura e ofruar dhe e propozuar i përcjell qasjet dhe tendencat didaktike – metodike në mësim nga aspekti i formave, metodave, mjeteve dhe strategjive të procesit mësimor.

Realizimi efikas i mësimin nga lënda Etika në religjione kërkon përgatitje solide të mësimdhënësit për secilën orë mësimore.

Hapi i parë në përgatitjen është definimi i qëllimit të orës e cila duhet të arrihet. Madje, çdoherë duhet të kihet parasysh se qëllimet e orës kanë të bëjnë me ndryshimet që duhet të ndodhin tek nxënësi si pasojë dhe rezultat i aktiviteteve të nxënësit dhe të mësimdhënësit gjatë orës. Duke e pasur parasysh faktin se qëllimi i orës ka karakter të përgjithshëm, për arritjen e saj nevojitet konkretizim i shprehur në detyrat e orës. Realizimi i detyrave çon drejt të arriturave të qëllimit. Për këtë arsye në përcaktimin e detyrave nevojitet që të plotësohen kushtet e caktuara nga aspekti i saj se ato duhet të dalin nga: qëllimi i cili duhet të arrihet; nga definimi i rrjedhës

së orës; nga zgjedhja dhe përcaktimi i aparaturës didaktike – metodike që do të shfrytëzohet në orën konkrete.

Artikulimi i mësimin nga aspekti i organizimit të brendshëm paraqet strukturimin (kompozimin, formësimin dhe modelimin) e procesit mësimor në njësinë e caktuar kohore. Me artikulin rregullohen etapat e punës në mësim, gjegjësisht përcaktohet mënyra e fillimit të punës mësimore, mënyrat e realizimit më efikas të procesit mësimore, mënyrat e kryerjes së punës mësimore dhe mënyrat e ndërlidhjes me punën e mëtejshme. Artikulimi i mësimin paraqet kompozicionin e procesit mësimor në njësinë e caktuar kohore. Prej këtu çështja e mikroartikulimit të mësimin është element kyç në përmbajtjen e doracakut. Mikroartikulimi i mësimin, kryesisht ka të bëjë me formësimin e punës mësimore gjatë orës mësimore. Kështu që artikulimi i orës mësimore si bazë themelore kohore dhe njësi organizative e punës edukative – arsimore është çështje e rëndësishme esenciale. Përputhshmëria përmbajtjesore dhe logjike - psikologjike e orës mësimore si dhe raportet interaktive ndërmjet mësimdhënësit, nxënësit, përmbajtjeve mësimore dhe rumbullakimeve didaktike – teknologjike gjatë 45 minutave e përcaktojnë efikasitetin e mësimin të shprehur përmes suksesit në mësim dhe të arriturat e nxënësit.

Artikulimi në orën mësimore zhvillohet në tri etapa: pjesa hyrëse, kryesore dhe përfundimtare. Madje artikulimi i orës mësimore paraqet mbikëqyrjen e elementeve themelore dhe formësimin e tërësisë nga të njëjtat. Ose me fjalë tjera realizimi i secilës etapë nuk është i ndarë në mënyrë rigoroze. Kështu që gjatë realizimit të gjithë etapat plotësohen dhe gërshetohen duke e përbërë një tërësi komplekse koherente.

Pjesa hyrëse e orës ka funksionin e preparatit dhe është pjesë integrale e të gjithë formave të orës mësimore. Sipas njohurive të fituara nga hulumtimet empirike didaktike – metodike, kohëzgjatja më efektive e pjesës hyrëse është 3 deri në 5 minuta. Pjesa hyrëse e orës është në funksionin e nxitjes së interesave të njohurive të nxënësit dhe përqendrimi i vëmendjes së tij ndaj përmbajtjeve të parapara mësimore. Në këtë kontekst përmbajtjet e pjesës hyrëse të orës mundet të jenë të ndryshme. Kështu që mundet të fillohet me: përsëritjen e përmbajtjeve paraprake me qëllim që të përcaktohet

niveli i njohurive të cilët janë përqendruar në vetëdijen e nxënësit dhe që do të shërben si hallkë me të cilën do të ndërlihet përmbajtja e re. Megjithatë, të nderuar mësimdhënës ndihmë e rëndësishme janë detyrat e shtëpisë, Në pjesën hyrëse të orës mundet të demonstrohet fotografi, gjësend, film i metrazhit të shkurtër, model ose të krijohet situatë problematike, të lexohet tekst i shkurtër. Gjatë zgjedhjes së përmbajtjeve për pjesën hyrëse të orës çdo herë duhet të merret parasysh se këtu krijohen kushte objektive dhe subjektive për arritjen e njohurive. Për këtë arsye pjesa hyrëse ka të bëjë me realizimin e njohurive, materialet – teknike, psikologjike, didaktike – metodike dhe komponentët organizative të mësimin.

Në pjesën kryesore të orës dedikohen përmbajtjet e reja. Gjegjësisht aktiviteti është i pari nga ana e mësimdhënësit. Gjithashtu më e dëshirueshme dhe më e nevojshme është që të aktivizohet nxënësi me qëllim që më tepër të nxitet dhe ta përqendroj interesin e tij si dhe të mbajë shkallë të lartë të koncentrimin të vëmendjes së tij.

Për pjesën përfundimtare të orës rregullohen rezultatet e punës, sillen përmbyllje dhe jepen detyra shtëpie. Qëllimi i kësaj etape të orës është që aktiviteti i nxënësit të mbahet përmes pjesëmarrjes aktive, si dhe përmbyllje.

HYRJE

LIDHSHMËRIA NDËRLËNDORE DHE NDËRËPËRMBAJTËSORE DHE ZBATIMI I NJOHURIVE DHE PËRVOJAVE

Me programin dhe planin mësimor lënda mësimore Etika në religjione është parapa në klasën e V si lëndë zgjedhore me 2 orë javore gjegjësisht 72 orë gjatë vitit shkollor.

Përmbajtjet e lëndës mësimore Etika në religjione mundësojnë që nxënësi të arrijë njohuri për etikën si shkencë për të mirën dhe moralin, njohuri për nocionin dhe rëndësinë e etikës dhe moralit, si dhe njohuri për të mirën si vlerë më e lartë etike. Nga aspekti funksional, përmbajtjet janë në funksionin e zhvillimit të aftësisë për njohjen, pranimin dhe zbatimin e rregullave për sjelljen e mirë dhe raportet humane midis njerëzve. Përmes këtyre përmbajtjeve nxënësi nxitet të përgjigjet për vetveten dhe për tjerët si dhe mënyra etike e gjykitimit. Gjithashtu, përmbajtjet e lëndës Etika në religjione paraqesin mundësi që nxënësi të njihet me etikën në mësimet e ndryshme religjioze si krishterimi ortodoks, islami, mësimi katolik, judaizmi, dhe të mësuarit evangjelic - metodistik . Nxënësit do të arrijnë njohuri për bazat e përbashkëta etike të religjioneve dhe parimeve etike të mësimin religjioz në librat e shenjta. Njëkohësisht përmbajtjet e programit do t'ju mundësojnë nxënësve të përvetësojnë njohuri të caktuara nga Bibla, Kurani, Talmundi.

Përveç kësaj këto nxënës do t'i përvetësojnë edhe mënyrat e leximit dhe të kuptuarit e përmbajtjeve në librat e shenjta.

Mësimi i përmbajtjeve të lëndëve tek nxënësit do të kontribuon për zhvillimin e aftësive për pranimin dhe respektin e përkatësisë së tyre të ndryshme fisnore, kombëtare dhe profesionale. Përveç se njohuritë e fituara se religjioni i mëson njerëzit për respektin dhe të kuptuarit e ndërsjellë mundësojnë tek nxënësit të zhvillohen shkathtësi për dialog, tolerancë, respekt dhe kooperim me tjerët, si dhe ndjenjat e solidaritetit dhe humanitetit.

LIDHSHMËRIA NDËRLËNDORE DHE NDËRPËRMBAJTËSORE DHE ZBATIMI I NJOHURIVE DHE PËRVOJAVE

Përmbajtjet e temës Etika si shkencë për të mirën dhe moralin bazohet në ngritjen dhe zhvillimin e personalitetit në tërësi dhe bashkësia e cila i përket, veçanërisht njohuritë për rëndësinë e etikës dhe moralit për jetën e secilit individ dhe aftësitë e përvetësimit dhe praktikumit të raporteve humane ndërmjet njerëzve, vetë respekt dhe respekt i ndërsjellët. Ata janë të lidhura ngushtë me përmbajtjet nga lëndët kulturo klasike në civilizimin evropian, Shoqëria, Etika si dhe Arsimit qytetar.

Njohuritë për bazat e përbashkëta etike të mësimave religjioze dhe vlerat themelore të njeriut, aftësitë për zbulimin se dimensionet etik të religjioneve është pjesë e përmbajtjeve të librave të shenjta, aftësia për mbikëqyrjen e rregullave të përbashkëta të sjelljes së mirë dhe jeta e përbashkët në mësimet religjioze, nxënësi do t'ij arrijë përmes pjesëve të përmbajtjeve në temën Etika në religjione. Përmes përmbajtjeve interesante për bazat teorike të mësimet religjioz, Bazueshmëria etike dhe bazat e moralit të secilit mësim religjioz në veçanti, nxënësi do të arrijë njohuri për dimensionet e përgjithshme etnike dhe të përbashkëta të krishterimit ortodoks, islamit, mësimet katolik, judaizmit dhe mësimet evangjelicë – metodistik. Lidhshmëria ndërlëndore e përmbajtjeve të kësaj teme me përmbajtjet e lëndëve kulturo klasike në civilizimin evropian, shoqëria, historia,etika si dhe arsimi qytetar është plotësisht natyral.

Tema e tretë është e ndarë në 5 module të cilat kanë statusin e zgjedhjes.

Moduli i parë zgjedhor Etika në mësimin krishterë ortodoks parasheh përmbajtje me të cilat nxënësi do të arrijë njohuri për bazat teorike të mësimet ortodoks krishterë, ekzistimin dhe përhapjen e krishterimit në Maqedoni, lindjen e shpëtimtarit Jezu Krishtit, jeta, vdekja dhe ringjallja e tij, rëndësia e shenjtoreve maqedonas që në tërësi korespondon me përmbajtjet nga gjuha maqedonishte dhe historia. Gjithashtu përmbajtjet e nxënësit duhet t'ij mundësojnë ta njeh Biblën si burim themelor të fesë krishtere, ta njeh ekzistimin e saj dhe vendin ku përdoret, por edhe t'ij aftësojë që t'ij lexojë dhe kuptojë tek-

stet biblike. Gjithashtu përmbajtjet nga ky modul (vepra Bazat etike të krishterimit ortodoks) do ta nxisin nxënësin t'ij njeh dhe pranoj dallimet midis njerëzve, origjinën e tyre (moshën, gjininë, kombësinë, religjionin etj) ta kuptojë arsyen se pse njeriu jeton me njerëzit tjerë; të njihet edhe me rregullat themelore për mbajtjen e raporteve të mira dhe punën me bashkësitë me njerëzit tjerë; të njihet dhe t'ij pranojë rregullat e raporteve të mira të ndërsjella të nxënësve në aktivitetet në klasë; t'ij pranojë rregullat e raporteve të mira me prindërit, të tregoj besimin dhe dashurinë ndaj të afërmeve në familje, të njeh se në bashkësi secili duhet të përpiqet për atë që duhet ta bëjë për jetën e përbashkët; të din të shpreh falënderim ndaj prindërve për dashurinë dhe kujdesin që vazhdimisht e ka prej tyre; ta njeh nevojën për sjelljen e tyre me respekt ndaj mësimdhënësve dhe shpirtave; të njeh mënyra që si t'ij ndihmojë prindërve të tyre; të din për shenjtërinë e Shën Mërisë e cila është shembull për të gjithë nënat në Vend. Këto përmbajtje në pjesën më të madhe janë në korrelacion të drejtpërdrejtë me tekstet nga lëndët arsimi qytetar dhe etika. Përmbajtjet nga pjesa e tretë nga moduli (Moralit krishterë ortodoks) janë në funksion të arritjes dhe zhvillimit të aftësive për zbulimin, pranimin dhe zbatimin e bamirësisë më të lartë krishtere si vepra të mira, dashuri, mençuri, drejtësi, trimëri, maturi, solidaritet, humanitet, mëshirë dhe ndihmë, mirëqenie, falënderim.

Njohuritë e fituara do t'ij mundësojnë nxënësit që ta kuptojë esencën dhe rëndësinë e jetës, gëzimin dhe punën ndërsa para së gjithash dashurinë si bazë e jetës së njeriut dhe mirëqenie. Këto përmbajtje në pjesën më të madhe janë të lidhura ngushtë me përmbajtjet nga gjuha maqedonishte, arsimi qytetar dhe etika, si dhe me pjesë nga përmbajtjet nga historia.

Moduli i dytë zgjedhor Etika në mësimin islam parasheh përmbajtje me të cilat nxënësi do të arrijë njohuri për bazat teorike të mësimet islam, do t'ij njohë gjashtë kushtet elementare të mësimet islam për Allahun xh.sh. krijues dhe falës. Përmes këtyre përmbajtjeve nxënësi do të arrijë njohuri për Muhamedin a.s si i dërguar i fundit i Allahut xh.sh. lindja e tij, jeta dhe vdekja, për krijimin e Kuranit dhe shpalljen e tij, për islam, si teori dhe praktikë dhe pesë kushtet e islamit si dhe dobia nga zbatimi i

tyre për zhvillimin shoqëror dhe individual dhe zhvillimi shoqëror; për pastërtinë, namazin, zeqatën dhe agjërimin në mësimin islam, si dhe për rëndësinë e haxhillëkut në mësimin islam. Gjithashtu përmes përmbajtjeve të këtij moduli (vepra Bazushmëria etike në islam) nxënësi do të arrijë njohuri për etikën islame në shkollë dhe rëndësia e shkollës në jetën e njeriut, etika islame në jetën familjare dhe në punë, për rregullat e sjelljes dhe përshëndetjes, si dhe për moralin e individit në shoqëri, përgjegjësinë për veten dhe ndaj tjerëve.

Këto përmbajtje janë të ndërlidhura me pjesë të përmbajtjeve nga historia. Përmbajtjet e pjesës së tretë të modulit (Bazat e moralit islam) janë në funksion të aritjes së njohurive dhe zhvillimin e aftësive për zbulimin, pranimin dhe zbatimin e karakteristikave të besimtarit të mirë si dashuri, solidaritet, humanitet, respekt, njohuri për rëndësinë e moralit në familje, shkollë, shoqëri, njohuri për mbrojtjen dhe përforcimi nga veprat e këqija si dhe për sjelljen islame dhe respektin ndaj festave. Këto përmbajtje në pjesën më të madhe janë të lidhura ngushtë me përmbajtjet nga arsimi qytetar dhe etika.

Përmbajtjet me të cilat nxënësi do të arrijë njohuri për bazat teorike të krishterimit katolik, bazat etike të krishterimit katolik moral janë të vendosura në modulën e tretë zgjedhor nga tema e tretë. Duke u njohur me të dhënat themelore për krishterimin katolik, nxënësit do të arrijnë njohuri për krijimin e mësimin katolik krishterë, lindjen e Krishtit dhe përshëndetjen Krishti është lind!, si dhe përshëndetjen Festoni!

Përmbajtjet për ngjarjet më të rëndësishme të jetës në Tokë të Zotit Jezu Krishtit do t'i mundësojnë nxënësit ta njeh përmbajtjen e lajmit të gëzueshëm të Isës, do t'ju ndihmojnë ta kuptojë rëndësinë e kryqëzimit, si dhe të fitojë njohuri për atë se si festohet Krishtlindja në kisha dhe në familje. Përmes përmbajtjeve për ringjalljen e Krishtit nxënësit do të njihen për dëshmitë biblike për vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit dhe do ta kuptojnë rëndësinë e Krishtit si shenjë e dashurisë së Krishtit dhe si shenjë e shenjtë e krishterimit. Përmbajtjet që kanë të bëjnë me krijimin e kishës së Krishtit dhe bashkësitë e para krishtere, si dhe roli i kishës në vazhdimin e veprës së Krishtit dhe rëndësia e shenjtoreve maqedonas janë të ndërlidhura me një pjesë të për-

mbajtjeve nga historia. Përmes përmbajtjeve të këtij moduli (vepra Baza etike e mësimin katolik krishterë) nxënësi do t'i përvetësojë nocionet, rregullat, raportet cilësore ndërmjet njerëzve, bashkësia, dallimet dhe ngjashmëritë midis njerëzve, lidhshmëria ndërmjet veti, ekologjia. Përmbajtjet në këtë pjesë do ta nxisin nxënësin t'i zbulojë, kuptojë dhe pranojë dallimet midis njerëzve, të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë për mbrojtjen e planetit tonë Tokë, shtëpinë dhe mëmëdheun si dhe të njihet dhe t'i përvetësojë rregullat për ruajtjen e mjedisit jetësor. Specifikat e këtyre përmbajtjeve janë në korrelacion me përmbajtjet nga arsimi qytetar, etika dhe ekologjia.

Përmbajtjet nga pjesa e tretë e modulit (moralit krishterë-ortodoks) janë në funksion të aritjes së njohurive dhe zhvillimit të aftësive për zbulimin e rëndësisë së fjalëve respekt, përgjegjësi, e vërtetë, dashuri, vepra të mira, drejtësi, vazhdueshmëri në jetën e përditshme. Përmes këtyre përmbajtjeve nxënësi do t'i njeh përparësitë dhe mungesat e veta, do ta shqyrtojë nevojën nga jeta e përbashkët me njerëzit tjerë, do t'i shqyrtojë problemet e të rinjve në pubertet, arsyet për mosmarrëveshjen me prindërit, do ta njeh rëndësinë e lirisë dhunti e Zotit. Lidhshmëria ndërlëndore e përmbajtjeve nga kjo temë me përmbajtjet e lëndëve gjuhë maqedonishte, arsimit qytetar dhe etika, si dhe me pjesë të përmbajtjeve nga historia.

Moduli i katërt zgjedhor Etika në judaizëm përmes përmbajtjeve për rëndësinë e judaizmit si bazë e religjioneve tjera, fillimi dhe zhvillimi i judaizmit, kultura hebraike në Maqedoni (vepra Bazat teorike të judaizmit) do t'i mundësojnë nxënësit ta njeh identitetin nacional të hebrenjve, të kuptojë se kush është Zoti në judaizëm, të njeh për holokaustin dhe vuajtjet, për atë se cilat janë librat e shenjta dhe si është roli i tyre dhe rëndësia në jetën e Hebrenjve. Përmbajtjet nga kjo pjesë janë të përqendruara në zhvillimin e ndjenjave të bashkëjetesës, dashurisë dhe bashkëpunimit, njohja me vlerat morale, si dhe nxitja dhe zhvillimi i fuqisë shpirtërore e nevojshme për krijimin e njeriut edhe ato me specifikën e tyre mund të krehen me përmbajtjet nga historia dhe gjuha maqedonishte. Pjesa e dytë e modulit ka të bëjë me varshmërinë etike të judaizmit dhe përfshinë përmbajtje të cilat kanë të bëjnë me rregullat për raporte të

mira, respekti i bashkësisë, toleranca dhe të kuptuarit, familja dhe morali familjar dhe raporti ndaj vetvetes dhe ndaj tjerëve. Specifika e përmbajtjeve mundëson integrim me përmbajtjet nga lëndët arsimit qytetar dhe etika. Përmbajtjet nga pjesa e tretë e modulit (Moraliteti në mësimin judaistik) janë në funksion të arritjes së njohurive dhe zhvillimit i aftësisë për kuptimin e rëndësisë së dashurisë ndaj njeriut, për mirësinë si dhënie më e madhe, dashuria ndaj njeriut, për mirësinë, mençurinë, besimin, trimërinë, maturinë, solidaritetin, humanitetin, mëshirën dhe ndihmën, mirëqenien, falënderimin dhe respektin. Këto përmbajtje në pjesën më të madhe janë të lidhura ngushtë me përmbajtjet e arsimit qytetar dhe etikën, ndërsa në pjesë të veçanta edhe me përmbajtje nga arsimit muzikor dhe figurativ.

Moduli zgjedhor Etika në mësimin krishterë evangjelicë – metodistik, parasheh përmbajtje me çka nxënësi do të arrijë njohuri për Biblën si zgjedhje themelore e fesë Krishtere, krijimi, zbatueshmëria dhe përmbajtja e Biblës, do t'i përvetësojë nocionet themelore në mësimin evangjelicë – metodistik dhe do të njihet me reformat e kishës Evangjelicë – metodistike (Martin Luter dhe Xhon Vesleji), puna dhe kontributi i saj kulturor, historik dhe shpirtëror në Maqedoni. Këto përmbajtje mundet të ndërliken me përmbajtje nga lënda e historisë. Pjesa e dytë e modulit përfshin përmbajtje të cilat kanë të bëjnë me rregullat për sjelljen e mirë me tjerët në bashkësi, në familje dhe ndaj vetes, vlerat themelore të bashkëjetesës siç janë kujdesi, ndihma, solidariteti, të kuptuarit dhe respekti që janë të lidhura ngushtë me përmbajtjet e lëndës arsimit qytetar. Përmbajtjet në pjesën e tretë të modulit Moraliteti në mësimin evangjelicë – metodistik janë orientuar ndaj arritjes së njohurive për mirëqenien më të larta krishtere për karakteristikat të cilat duhet t'i posedojë secili krishterë siç janë solidariteti, humaniteti ndihma, mëshira, për rëndësinë e dashurisë, punës, jetës, drejtësisë, të vërtetës. Përmes tyre lidhshmëria ndërliken me përmbajtjet nga etika është plotësisht e natyrshe, mirëpo nuk është përjashtuar as lidhshmëria me përmbajtjet nga lëndët arsimit figurativ.

Ose me fjalë tjera, në secilin prej moduleve zgjedhore përmbajtjet janë fokusuar në bazat teorike të mësimin të caktuar religjioz, bazat etike dhe moralitetit të secilës

nga ato (krishterimi ortodoks, islami, mësimi katolik, mësimi evangjelicë – metodistik, judaizmi). Përmbajtjet në secilin modul të temës së tretë janë të lidhura ngushtë me përmbajtjet nga kultura klasike në civilizimin evropian, shoqëri, histori, arsimit qytetar dhe etika, ndërsa në disa pjesë edhe me përmbajtjet nga arsimit muzikor dhe figurativ dhe ekologjia.

Lidhshmëria ndërpermbajtësore është e shprehur në përmbajtjet në tërësi. Kështu që njohja me esencën dhe rëndësia e nocionit etika dhe morali, rëndësia e saj e veçanërisht njohuritë për të mirën si vlerë e lartë etike janë themelore në formimin e njohurive për etikën e religjioneve, njohuritë për vlerat themelore të njeriut, e para së gjithash njohuritë dhe parimet e mësimin religjioz. Nga ana tjetër njohuritë për bazat etike të përbashkëta dhe parimet e mësimin religjioz janë bazë në të cilën themelohen njohuritë për bazat teorike të religjioneve të caktuara, bazat etike të sajë dhe bazat e moralitetit të secilit mësim religjioz.

1. ETIKA SI SHKENCË PËR TË MIRËN DHE MORALIN

Paraqitja e përmbajtjeve mësimore

Përmes përpilimit të përmbajtjeve nga kjo temë mësimore nxënësit duhet të njihen me etikën si shkencë për të mirën dhe moralin, t'i përvetësojnë nocionet etika dhe morali dhe t'i kuptojnë esencën dhe rëndësinë e saj. Njohja me të mirën si vlerë më e lartë etike ka për qëllim të zhvillojë aftësi për njohjen dhe pranimin e raporteve humane ndërmjet njerëzve, të nxit mënyrën etike të paragykimëve të së mirës si vlerë më e lartë njerëzore.

1.1. Nocioni etika

Etika është disiplinë filozofike e cila i hulumton qëllimet dhe kuptimin e kërkesave morale, si dhe kriteret themelore për vlerësimin e veprimeve morale. Mësimi bashkëkohorë i teorive dhe historive etike nuk është i mundshëm pa shqyrtimin e burimeve dhe themeleve të saj që prekin në mendimet filozofike të Greqisë Antike. Etika helene është mësuere jo vetëm e etikës dhe shkencës sonë por edhe e tërë kulturës sonë shpirtërore. Vetë fjala etikë është me origjinë greke

(ethos – zakon dhe ethis – moral). Nga kjo del se etika është shkencë mbi moralin. Termi etikë dhe pavarësia e etikës si disiplinë e veçantë etike janë të ndërlidhura për Aristotelin e cili i pari e ka përdorur fjalën etikë në veprën e tij Etika e Nikomahut. Ai i ka ndarë vlerat njerëzore në intelektuale dhe etike morale. Më së shpeshti në teorinë përdoren termet etika dhe morali. Megjithatë ndërmjet tyre ekziston dallim i rëndësishëm për shkak se në esencë, morali definohet si dukuri e caktuar shoqërore, veprim komplet dhe mënyrë e sjelljes së individëve dhe kolektiveve në jetën e përditshme. Përderisa etika është shkencë gjegjësisht teori për moralin. Në realitet nuk bëhet dallim i madh ndërmjet etikës dhe moralit. Ata gjithashtu mundet të dallohen si teori (etikë) dhe praktikë (moral). Mirëpo as atëherë ata nuk janë në pozicion të caktuara në mes veti.

1.2. Rëndësia e etikës

Është e njohur sintagma „Pa teori nuk ka praktikë“. Në atë kontekst të rinjtë duhet të përgatiten për jetë me njerëzit tjera, të adaptohen me traditat dhe sjelljet dhe t’i mësojnë normat pozitive të veprimit në të gjithë sferat ku do të paraqiten. Etika është shans e cila duhet të mundësojë që njerëzit të mendohen dhe të vetëdijeshohen, të angazhohen në gjetjen e rrugëve dhe normave më të mira për pengim të suksesshëm të dukurive destruktive në shoqëri ku janë të nënshtruar të gjithë njerëzit e Vendit, ku është edhe rëndësia e etikës. Rëndësia e etikës është më e madhe kur do të merret parasysh fakti se ajo duhet të mundësojë që gjeneratat e reja të përgatiten për obligimet më të mëdha, ku obligimi të jesh njeri, serioz, bamirës është detyrë themelore jetësore e secilës qenie të gjallë.

1.3. Nocioni moral

Në kuptimin më të gjerë moralin mund ta definojmë si një nga mënyrat për rregullimin e raporteve ndërnjerëzore, gjegjësisht si përmbledhje e normave shoqërore, rregullave dhe parimeve për sjelljen e njeriut në shoqëri. Sa i përket rëndësisë së burimit të moralit rrjedh nga gjuha latina (mos, moris-traditë, rregull, ligj; mores – mënyrë e sjelljes së njerëzve dhe kuptimi i asaj sjellje, moralis – i moralshëm).

Morali është një nga format e praktikës njerëzore ku shprehet raporti praktik, aktiv dhe real i njeriut ndaj botës së jashtme dhe ndaj vetvete, ndaj njerëzve tjerë, mjedisi shoqëror, ndaj punës dhe ndaj vlerave materiale dhe shpirtërore. Njihet në vlerësimin e kërkesave dhe veprimeve njerëzore si të mira dhe të këqija. Madje qëllimet dhe veprimet e mira vlerësohen pozitivisht, lejohen, rekomandohen ose krijohen, ndërsa të këqijat vlerësohen negativisht, nuk lejohen, pengohen dhe gjykohen. Kështu që mund të themi se morali paraqet formësim aktiv, orientim dhe vlerësim të veprimeve personale dhe të huaja. Kjo nënkupton se nocioni sjellje, veprimet e njerëzve, vlerësimi i tyre me vlerë dhe definomi si pozitive dhe të mira ose si negative dhe të këqija. Morali është një nga nevojat primare jetësore, një nga format e vetëdijes njerëzore shoqërore, gjegjësisht shoqëror me ndihmën e së cilës individi integrohet në bashkësinë shoqërore. Pa atë lidhje jeta e përbashkët nuk mundet as që të paramendohet. Njeriu është qenie individuale por edhe qenie shoqërore.

1.4. Rëndësia e moralit

Morali është përbërje qenësore pjesë përbërëse e jetës në bashkësi. Është krijuar si nevojë e shoqërisë njerëzore që t’i rregullojë raportet ndërmjet njerëzve. Është zhvilluar paralel me zhvillimin e bashkësisë njerëzore dhe gjendet në shërbimin e rregullimit të raporteve ndërmjet njerëzve. Si formë e vetëdijes shoqërore morali është krijuar në momentin kur individi ka qenë i detyruar që nxitjet e tij individuale t’i përputh me nevojat e bashkëjetesës. Ai paraqet proces të formësimit të individit në personalitetin shoqëror. Me vetë atë morali e kufizon individin në veprimet e tij, por për revansh e inkudron si anëtar i barabartë në bashkësi dhe përveç asaj i mundëson të drejta dhe liri të caktuara.

1.5. E mira si vlerë më e lartë etike

Bazat themelore të etikës janë e mira dhe e keqja. Në etikë rrotullohet e tërë rreth tyre. Ato u japin kuptim moralit. Secili përcaktim për moralin është diçka e mirë apo e keqe. Përmes këtyre kategorive shprehen të gjithë qëllimet dhe veprimet e njerëzve. Vështirë është që të jepet përcaktim i saktë se çka është e mirë e çka për-

mban ajo. E mira përcaktohet nga vetë vetja sipas vlerës së lartë të saj dhe sipas nevojës jetësore të sajë. Gjithashtu ajo mundet të përcaktohet për shembull, si diçka që dëshirohet apo është e nevojshme ose si diçka për kryerjen e së cilës jepen norma morale ose si element që krijon jetë të drejtë ose fat. Ose në qoftë se e mira është ajo që kushton dhe është e mirë, në kuptimin e njohurive kemi bërë hap përpara në procesin e të shprehurit të së mirës. Vetë ne e dimë se çka është e mirë e çka nuk është e mirë. Nga nocioni e mirë kanë dalur dhe rëndësinë e kategorive tjera të etikës. Ata paraqesin formulim më të ndryshëm të kategorive themelore etike ndërsa kanë vlera dhe rëndësi: morale dhe jo morale, etike dhe jo etike, drejtë dhe jo drejtë, me vlerë dhe pa vlerë, ajo që vlerësohet dhe ajo që nuk vlerësohet e dëshirueshme dhe e padëshirueshme. Me termin e mirë në lidhje janë edhe elementet tjera strukturore të etikës – vetëdija morale, vullneti, norma, veprimi, vlerësimi, sanksioni. „Nuk duhet të bëjnë keq, që të shihet e mira“ (proverb latine)

Organizimi i mësimit

Për këtë temë janë paraparë 10 orë ose nga 2 orë për secilën përmbajtje. Duke e pasur parasysh natyrën e përmbajtjes vend më adekuat i realizimit është klasa me mundësi për zbatimin e LCD projektorit dhe zbatimi i formës individuale dhe kolektive të punës. Përmbajtja e cila ka të bëjë me përcaktimin e termit etikë ka për qëllim t'i njej nxënësit me nocionin dhe esencën e etikës. Përpilimi mund të fillojë me teknikën turmë idesh me çka mësimit nxënësi do t'i nxit nxënësit të numërojnë fjalë të cilat sipas tyre janë të lidhura ngushtë me termin etikë. Përderisa do të shkruhen në tabelë, mundet të kalojnë në analizë të ilustrimeve ku janë të paraqitura raportet ndërmjet njerëzve. Analiza e përmbajtjeve të ilustrimit zhvillohet përmes dialogut ndërmjet mësimit nxënësit dhe nxënësit, ndërsa fjalët me të cilat përshkruhen ilustrimet gjenden në fjalët e shkruara nga aktiviteti paraprak (në qoftë se janë shënohen, ndërsa në qoftë se nuk janë përshkruhen). Nga diskutimi gradualisht zbatohen përfundime për esencën e termit etikë. Ose nxënësit marrin tekst ku përshkruhen raporte të caktuara ndërmjet njerëzve ose sjellje të llojeve të ndryshme, e anali-

zojnë dhe gradualisht zhvillohet diskutim prej ku realizohet përfundim për atë se etika është shkencë për moralin.

Gjatë përpilimit të përmbajtjeve për rëndësinë e etikës duhet të përdoren njohuritë paraprake dhe përvojat për nocionin dhe esencën e etikës. Është e preferuar që nxënësve t'ju prezantohen ilustrime për lloje të ndryshme të sjelljes.

Rekomandimet didaktike – metodike

Shembulli 1. Çka është etika?

Qëllimet: Nxënësit të njihen me termin dhe esencën e etikës si shkencë për moralin. Njëkohësisht njohuritë e arritura do të mundësojnë përhapje të frymës etike, serioziteti etik, përgjegjësi dhe kreativitet.

Mjetet mësimore: tekste dhe ilustrime.

Metoda mësimore: biseda, sqarimi, demonstrimi, tekst – metoda.

Vendi i realizimit: klasa.

Rrjedha e aktiviteteve:

Hyrëse (preparative) – Nxënësit i analizojnë ilustrimet e demonstruara ku janë paraqitur marrëdhënie të caktuara ndërmjet njerëzve

Operative (mësimdhënies – mësimnxënies) – Në bazë të përmbajtjes nga ilustrimi mësimit nxënësi zhvillon bisedë me nxënësit dhe në bazë të sjelljeve të përbaškëta sjell përmbyllje për atë se çka është etika..

Aktivitetet evaluative: Mësimdhënësi shfrytëzon burim tekstual kështu që në bazë të analizës së përmbajtjeve të tekstit nxënësit e përcaktojnë sjelljen etike të figurave në tekst.

Shembulli 2. Çka është morali?

Qëllimet: Nxënësit të njihen me nocionet e mirë dhe e keqe, e drejtë, e dobishëm, e bukur dhe tërë ajo që e definojnë sjelljen pozitive të një personi.

Mjetet mësimore: tekstet,

Metodat mësimore: bisedë dhe sqarim, lexim dhe punë me tekst.

Vendi i realizimit: klasa.

Rrjedha e aktivitetit:

Hyrëse (preparative)- Nxënësit marrin tekst të shkurtër: Parabola për të dashurin Samarjanin (Luka 10,

30 – 37) dhe kanë detyrë t'i analizojnë figurat në tekst sipas sjelljes së tyre dhe veprat në të mira dhe të këqija. Përmbylljet nga analiza e tekstit e vënë në tabelë e cila paraprakisht është e shkruar në tabelë (mundet të përdoret edhe hamer edhe letër) dhe e ndarë në dy pjesë. Në njëërë kolonë i shkruajnë sjelljet pozitive ndërsa në tjetrën ato negative. Kështu që përdoret organizues grafik i mësimimit.

Operative (të mësimdhënies – mësimnxënies) – Në bazë të përmbajtjeve të tekstit mësimdhënësi zhvillon bisedë me nxënësit dhe në bazë të kësaj bashkërisht sjellin përmbyllje për atë se çka është sjellje e mirë e çka është e keqe, cilat janë karakteristikat e veprave të mira e cilat janë veprat e këqija. Kështu që vijmë në përfundim se morali është përmbledhje e rregullave dhe mënyra të sjelljes së personalitetit ndaj vetes dhe ndaj tjerëve dhe në përgjithësi ndaj vlerave materiale dhe shpirtërore në shoqëri.

Aktivitetet evaluative – nga nxënësit kërkojmë që të theksojnë terme të cilat e përcaktojnë sjelljen pozitive të secilit nga këto (toleranca, sinqeriteti, drejtësia, mirëqenie, solidaritet, dashuri, besim) dhe nocionet t'i fusin në tabelë (në qoftë se paraprakisht nuk janë shënuar në kolonë adekuate).

Përcjellja dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve: Pritet që nxënësit t'i dinë nocionet kyçe nga tema siç janë etika, morali e mira si vlerë më e lartë etike. Nevojitet që nxënësi t'i dallojë nocionet etika dhe morali. Gjithashtu te nxënësi duhet të zhvillohet aftësia për njohjen e formave të sjelljes pozitive siç janë toleranca, sinqeriteti, drejtësia, shkathtësia, dashuria, besimi. Veçanërisht pritët t'i pranojnë si te vetat dhe t'i shprehin në sjelljen e tyre.

Të arriturat e nxënësve mund të evaluohen edhe përmes aktiviteteve në diskutim, pjesëmarrjes në punën kolektive, suksesit në zgjidhjen e ushtrimeve.

Vetëevaluimi i nxënësit mund të arrihet me ndarje precize të detyrimeve të anëtarëve të kolektivit.

Paraqitja e përmbajtjeve mësimore

2. ETIKA NË RELIGJIONE

Përmes përpilimit të përmbajtjeve të kësaj teme nxënësit duhet të njihen dhe t'i përvetësojnë parimet e përbashkëta etike të mësimimit religjioz, t'i zbulojnë mësimet etike të religjioneve të përfshira në librat e shenjtë, t'i shohin për sjelljen e mirë dhe jetën e përbashkët të religjioneve dhe njohin rregullat e përbashkëta në religjionet. Njohja me vlerat themelet bamirësitë –e njeriut në funksion të zhvillimit të personalitetit pozitiv moral të nxënësit dhe dimensionimi pozitiv i sistemit të vlerave shoqërore. Gjithashtu përmes përmbajtjeve të kësaj teme nxënësit do të njihen me të dhënat themelore të krishterimit ortodoks dhe ngjarjet më të rëndësishme të jetës së Zotit Jezu Krishtit. Përmes përmbajtjeve nga tema nxënësit do të arrijnë njohuri për përhapjen dhe zhvillimin historik të krishterimit në Maqedoni, si dhe rëndësinë e shenjtoreve maqedonas dhe kishat më të rëndësishme në Maqedoni. Përmbajtjet e temës janë në funksion të arritjes së njohurive për Biblën si libër i shenjtë për të gjithë krishterët. Në kuadër të kësaj teme nxënësit do të njihen me dallimet ndërmjet njerëzve dhe origjinës së tyre, profesionale dhe kombëtare. Përmes përmbajtjeve të kësaj teme nxënësit do të njihen me rregullat themelore të krishterimit për mbajtjen e raporteve të mira të familjes dhe në bashkësi, si dhe zhvillimi i bashkëjetesës. Përmes përmbajtjeve nxënësit do të arrijnë edhe aftësi për largimin e veprimeve të këqija, formimi i mendimit personal për sjelljen e keqe, njohuri për rëndësinë e bamirësisë në mjedisin shoqëror. Gjithashtu nxënësi duhet të kuptojë se secili njeri mundet të gabojë, se dashuria është bazë e jetës së njeriut dhe mirëqenies, t'i kuptojë dhe t'i ketë të qarta rëndësinë dhe nevojën për falënderim ndaj Zotit dhe prindërve dhe të folurit e së vërtetës.

Përmbajtjet nga tema do t'ju mundësojnë nxënësve të njihen me gjashtë kushtet elementare të bindjes në mësimin islam. Kështu që nxënësit duhet të kuptojnë se Allahu xh.sh. është një i plotfuqishëm sipas besimit islam, ndërsa i dërguari i fundit i tij është Muhamedi a.s. Nxënësit duhet të njihen se si është shpallur Libri i Allahut xh.sh. dhe ta njohin esencën dhe dobinë e zbatimit të pesë rregullave të islamit. Përmbajtjet tematike për di-

mensionin etik të islamit janë në funksion të arritjes së njohurive për rëndësinë e arsimit për jetën e njeriut dhe njerëzit e arsimuar. Në kuadër të njohurive për bazat etike të islamit nxënësi do të njihet me vlerat etike siç janë respekti ndaj prindërve, sjellja e mirë me vëllezërit e tyre, motrat dhe më të afërmit, interesi dhe mëshira ndaj fëmijëve të vegjël: dashuria, respekti dhe të kuptuarit në familje, respekti ndaj tjerëve pa dallim feje dhe kombësie. Gjithashtu nxënësi do të arrijë njohuri dhe aftësi për bazat e moralit në islam edhe atë në drejtim të mënyrës së shprehjes së dashurisë dhe humanitetit ndaj tjerëve, aftësisë për të kuptuarit të rëndësisë së nderit.

Përmbajtjet e kësaj teme do t'i mundësojnë nxënësit ta kuptojë dhe dijë krishterimin ortodoks dhe ngjarjet më të rëndësishme të jetës së Jezu Krishtit. Njëkohësisht nxënësi do të njihet me faktet biblike për ringjalljen e Krishtit, do të njihet me bazat teorike të mësimit krishterë katolik dhe do ta kuptojë rëndësinë e Biblës si libër i shenjtë për të gjithë krishterët. Gjithashtu nxënësit do të arrijnë njohuri dhe do të zhvillojnë aftësi për të kuptuarit e rregullave të krishterimit për mbajtjen e raporteve të mira në familje dhe në bashkësi, si dhe për 10 urdhrat e Zotit që në esencë e kanë dashurinë ndaj Zotit dhe të afërmit.

Gjatë përpilimit të përmbajtjeve të kësaj teme nxënësit do të arrijnë njohuri dhe aftësi për të dhënat themelore për mësimin evangjelicë -metodistik dhe ngjarjet më të rëndësishme nga jeta e Zotit si dhe njohuri për atë se Bibla është burim themelor i fesë krishtere. Në kuadër të këtyre përmbajtjeve nxënësit do të njihen me zhvillimin historik të kishës Evangjelicë – metodistike dhe funksioni i saj në Maqedoni. Nxënësit gjithashtu do të arrijnë njohuri për bazat e moralit etik dhe vlerat morale në mësimin evangjelicë – metodistik.

Nxënësit gjatë përpilimit të përmbajtjeve nga tema do të njihen me të dhënat themelore të judaizmit, origjina dhe historia.

Në kuadër të këtyre përmbajtjeve ata do të arrijnë njohuri për rrënjët dhe elementet e përbashkëta të judaizmit, identiteti kombëtar i Hebrenjve, si dhe bazat e vlerave morale të judaizmit.

2.1. Parimet e përbashkëta etike të mësimëve religjioze

Përmbajtjet kanë për qëllim që nxënësit të njihen me parimet e përbashkëta etike të mësimëve religjioze në librat e shenjta, t'i shohin dhe njohin rregullat e përbashkëta për sjelljen e mirë dhe jetën e përbashkët në religjionet. Njohja me bamirësitë themelore – vlerat e njeriut është në funksion të zhvillimit pozitiv moral të personalitetit të nxënësit dhe dimensionimi pozitiv të sistemit të vlerave shoqërore. Përpilimi i teksteve mundet të realizohet përmes modelit problematik të mësimi. Në fillim krijohet situatë problematike. Dëshmia: Secili njeri nga cila do pjesë e botës ka religjionin e tij dhe ka parimet e veta morale me të cilët përqendrohet. Të gjithë religjionet ekzistuese më tepër apo më pak, flasin për moralin, për jetesën sipas rregullave morale, për dashurinë, për atë se si ta mbrojmë të mirën me dinjitet, e ta largojmë të keqen, se si të jemi të lumtur në këtë jetë; është në funksion të përgatitjes së nxënësve për punën hulumtuuese. Pastaj nxënësit ndahen në grupe, ndërsa secili grup ka detyrë diferenciale. Grupi i parë do të hulumtojë për parimet etike të krishterimit ortodoks, e dyta për parimet etike të islamit, e treta për parimet etike të mësimi katolik, grupi i katërt do të hulumtojë për parimet etike të mësimi evangjelicë – metodistik, ndërsa e pesat për parimet etike të judaizmit. Në hulumtim nxënësit do t'i shfrytëzojnë librat e shenjtë: Biblën, Kuranin, Talmudin, si dhe shkrimet fetare. Për të dhënat e mbledhura secili nga grupet do të udhëheq shënim që do ta prezantojë para nxënësve të paralele. Pastaj me krahasimin e punës së secilit grup do të vihet në përfundim se parimet e përbashkëta etike të mësimi të religjioneve janë: mos vrit, mos dëshmo rrejtshëm, mos vjedh, respektoj prindërit dhe duaji të afërmin. Pasi që baza themelore ku krijohen parimet etike në mësimet religjioze është dashuria.

2.2. Bazat teorike të ortodoksisë

Përmbajtjet nga kjo temë do t'ju mundësojnë nxënësve që të njihen me shenjat themelore të krishterimit ortodoks dhe ngjarjet më të rëndësishme nga jeta e Jezu Krishtit. Përmes përmbajtjeve nxënësit do të arrijnë njohuri për përhapjen dhe zhvillimin historik të krishterit-

mit në Maqedoni, si dhe për rëndësinë e shenjtoret maqedonas dhe kishat më të rëndësishme në Maqedoni. Përmbajtjet gjithashtu janë në funksion të arritjes së njohurive për Biblën si libër i shenjtë për të gjithë krishterët.

Përpilimi i këtyre përmbajtjeve do të fillojë me vështrim të shkurtër historik për zhvillimin dhe krijimin e krishterimit dhe ndarja e Kishës Krishtere në vitin 1054. Në Lindore – Ortodokse dhe Perëndimore – Katolike – Romake për çka do të zhvillohet bisedë pas të shikuarit të filmit për krijimin dhe ndarjen e krishterimit. Pastaj vijon përpilimi i përmbajtjeve për ngjarjet më të rëndësishme nga jeta e Jezu Krishtit, lindja e tij dhe rinia, kryqëzimi, shtytja, ringjallja dhe vuajtjet që do të zhvillohet përmes leximit dhe punës me tekstet nga Evangjelia. Për përpilimin e teksteve të cilët kanë të bëjnë me përhapjen e krishterimit në Maqedoni (për apostull Pavle i cili i pari e ka përcjell lajmin për Krishtin e ringjallur në Maqedoni, njëherit edhe në Evropë me kryqëzimin e maqedonases Lidija) dhe veçanërisht për rëndësinë e shenjtoreve maqedonas Shën. Klimenti dhe Shën. Naum i Ohrit mundet të shfrytëzohen biografite e tyre të mbështetura me ikonat e tyre, si dhe fotografi të kishave më të rëndësishme në Maqedoni. Në atë mënyrë nxënësit do të arrijnë njohuri për rëndësinë e Biblës si libër i shenjtë për të gjithë krishterët.

2.3. Bazueshmëria etike e krishterimit ortodoks

Përmes teksteve për bazueshmërinë etike të krishterimit ortodoks nxënësit do të arrijnë njohuri për dallimet ndërmjet njerëzve dhe origjinën, moshën, gjininë, kombësinë, dhe fenë e tyre. Madje do të zhvillohen aftësitë për pranimin e dallimeve ndërmjet njerëzve që janë shprehje e përvetësimit të rregullave të krishterimit për mbajtjen e raporteve të mira në familje edhe në shoqëri, siç janë rregullat për sjelljen e mirë, respektin, përgjegjësinë e personalitetit në bashkësi. Nxënësit veçanërisht do të arrijnë njohuri dhe do të zhvillojnë aftësi për angazhimin personal për shkak të jetës së përbashkët. Këto përmbajtje mundet të përpilohen përmes bisedës për përvojat e nxënësve dhe shembuj të nxënësve nga jeta e përditshme të cilët flasin për llojet e ndryshme të sjelljes ndaj prindërve, në familje.

2.4. Bazat e moralit krishterë - ortodoks

Përmes përmbajtjeve nxënësit do t'i njohin bami-rësitë në jetën e krishterëve, do të arrijnë njohuri dhe aftësi për shmangien e veseve të këqija, formimin e mendimit personal për sjelljen e keqe, njohuritë për rëndësinë e humanitetit në bashkësinë jetësore. Gjithashtu nxënësi do të kuptojë se secili nxënës mundet të gabojë, se dashuria është bazë dhe mirëqenie e jetës njerëzore, do ta kuptojë dhe pranojë rëndësinë dhe nevojën e falënderimit ndaj Zotit dhe ndaj njerëzve veçanërisht ndaj prindërve. Përmbajtjet do ta nxisin nxënësin të mendojë për rëndësinë e jetës dhe punës në formimin e personalitetit, veçanërisht rëndësia e të folurit të vërtetës dhe rëndësia e besimit.

2.5. Bazat teorike të mësimin në islam

Përpilimi i këtyre përmbajtjeve do të fillojë me vështrim të shkurtër të zhvillimit historik të islamit, gjegjësisht me krijimin dhe përhapjen e islamit. Përmbajtjet do të mundësojnë që nxënësit të njihen me gjashtë kushtet elementare të bindjes në mësimin islam, do të njihen me faktin se si është krijuar dhe si është shpallur libri i shenjtë i myslimanëve – Kurani dhe do të njihen me pesë rregullat e islamit dhe dobinë nga zbatimi i saj. Kjo do të mundëson që nxënësit të njihen se Allahu është një dhe se Allahu xh.sh. është i madhërishtë sipas mësimin islam është se edhe Muhamedi a.s. është i dërguari i fundit i Allahut.

2.6. Bazueshmëria etike në islam

Njohja e nxënësve me këto përmbajtje do t'i mundësojë ata të arrin njohuri për faktin se islami i nxit njerëzit në arsim dhe se duhet të vlerësohen dhe respektohen njerëzit e arsimuar. Përmbajtjet do të mundësojnë nxënësit të kuptojë se duhet t'i respektojnë prindërit dhe se si t'i pranojë dhe praktikojë sjelljen e mirë ndaj vëllezërve, motrave dhe ndaj më të afërmeve dhe raportit i tij ndaj fëmijëve të plotësohet me dashuri dhe mëshirë. Ta kuptojë rolin e familjes në shoqëri dhe ta respektojë të kuptuarit dhe dashurinë në familje. E gjithë kjo duhet t'i mundësojë nxënësit të kuptojë se duhet t'i respektojë të gjithë njerëzit pa dallim feje ose kombi.

2.7. Bazat e moralit islam

Këto përmbajtje mësimore do t'ju mundësojnë nxënësve t'i njohin vlerat themelore të moralit në islam, gjegjësisht të kuptojnë se duhet t'i duan të gjithë njerëzit dhe të cilat punë janë të vlefshme në jetën e njeriut. Gjithashtu dhe se ekzistojnë shumë mënyra me të cilat mund t'ju ndihmojmë njerëzve tjerë dhe të tregojmë humanitet ndaj tyre dhe se sinjeriteti është një ndër vetitë më të rëndësishme të njeriut. Pastaj nxënësit do të arrijnë njohuri dhe do të kuptojnë për rëndësinë dhe respektin në familje dhe shkollë, do të kuptojnë se në asnjë mënyrë nuk mundet t'i mbulojnë veprimet e këqija nga Allahu xh.sh. dhe të shohin se bërja e veprave të këqija është diçka e keqe por dhe të kuptojnë se dyert e pendimit janë çdoherë të hapura ndërsa pendimi i falëgabimet.

2.8. Bazat teorike të mësimi katolik

Përmes përmbajtjeve të cilat kanë të bëjnë me bazat teorike të mësimi katolik nxënësit do të njihen me zhvillimin historik të krijimit të krishterimit dhe ndarja e krishterimit në lindor dhe perëndimor, gjegjësisht në krishterimin ortodoks dhe katolik, me çka do të krijohen kushte që nxënësit të përvetësohen me njohuri për karakteristikat themelore të krishterimit katolik dhe ngjarjet më të rëndësishme nga jeta e Jezu Krishtit. Përmes këtyre përmbajtjeve nxënësit do të njihen me faktet biblike për ringjalljen e Krishtit, do t'i përvetësojnë nocionet themelore për mësimin katolik krishterë, do ta njohin rëndësinë e shenjtoreve dhe do të përvetësohen me njohuri se Bibla është libër i shenjtë për të gjithë krishterët.

2.9. Bazueshmëria etike e mësimi katolik

Përmbajtjet për bazueshmërinë etike të katolicizmit kanë për qëllim të tregojnë faktin se vlerat etike do t'ju mundësojnë t'i njohin dhe pranojnë dallimet ndërmjet njerëzve të cilët dalin nga origjina, kombësia, feja etj. Gjithashtu këto përmbajtje do t'i njohin nxënësit me rregullat themelore krishtere për mbajtjen e raporteve të mira në familje dhe në bashkësi dhe se në bashkësi të gjithë duhet të angazhohen për atë që duhet ta bëjnë në jetën e përbashkët.

2.10. Bazat themelore të moralit të krishterimit katolik

Përmbajtjet e titulluara si Baza të moralit krishterë katolik do të mundësojnë nxënësve t'i njohin dhe sqarojnë dhjetë urdhrat e Zotit dhe të shqyrtojnë se urdhrat kanë të bëjnë me dashurinë ndaj Zotit dhe se janë rregulla për jetë të drejtë dhe të lumtur për të gjithë njerëzit në Tokë. Më tutje, përmes këtyre përmbajtjeve ata do të kuptojnë se dashuria është themel i jetës dhe mirëqenies njerëzore, do ta njohin rëndësinë dhe nevojën e falënderimit ndaj Zotit dhe ndaj njerëzve, do të njihen me faktet pse është e rëndësishme dhe mirë që çdoherë të flitet e vërteta dhe t'i vështrojnë dhe emërojnë rreziqet nga varshmëritë bashkëkohore ku të rinjtë zihen sot, si dhe t'i njohin gjërat e këqija në bashkësi dhe ndikimet e këqija shoqërore.

2.11. Bazat teorike të mësimi evangjelicë – metodistik

Në kuadër të këtyre përmbajtjeve nxënësit do të njihen me të dhënat themelore për mësimin evangjelicë – metodistik dhe ngjarjet më të rëndësishme nga jeta e Jezu Krishtit. Këto përmbajtje gjithashtu do të mundësojnë që nxënësit të kuptojnë se Bibla është burim themelor i fesë krishtere, do të njihen me historinë e kishës evangjelicë - metodistike dhe me punën e saj.

2.12. Bazueshmëria etike e mësimi evangjelicë – metodistik

Përmbajtjet ku në korniza të veta e trajtojnë problemin për bazueshmërinë etike të mësimi evangjelicë – metodistik duhet që nxënësve t'ju tregohet me faktin se vlerat etike do t'ju mundësojnë t'i njohin dhe pranojnë dallimet ndërmjet njerëzve që dalin nga origjina, nacionaliteti dhe feja etj. Gjithashtu këto përmbajtje do t'i njohin me rregullat themelore evangjelicë – metodistike për mbajtjen e raporteve të mira në familje dhe në bashkësi dhe se ato duhet të angazhohen për atë se çka duhet ta bëjnë në jetën e përbashkët.

2.13. Bazat e moralit të mësimit evangjelicë – metodistik

Përmes përmbajtjeve të cilat e trajtojnë çështjen e bazave të moralit të mësimit evangjelicë – metodistik nxënësit do të kenë mundësi ta kuptojnë dhe ta njohin se pse duhet t'i shmangemi sjelljes së keqe dhe të mohet mendimi për veprimet e këqija, të praktikohet humaniteti në shoqëri, por dhe të konstatohet se secili njeri mund të gabojë. Më tutje përmes përmbajtjeve nxënësit do të nxiten të mendojnë për rëndësinë e jetës, për rëndësinë e punës në formimin e personalitetit, të zbulojnë se pse është e rëndësishme çdoherë të flitet dhe të kuptohet rëndësia e besimit në bamirësinë e krishterimit.

2.14. Bazat teorike të judaizmit

Në kuadër të Bazave teorike të judaizmit nxënësit do të njihen me të dhënat themelore të judaizmit, origjinën dhe zhvillimin historik si dhe me identitetin kombëtare të Hebrenjve. Gjithashtu këto përmbajtje do të mundësojnë që ata të kuptojnë se duhet të nxitet respekti ndaj judaizmit, të dinë se çka është e rëndësishme për atë, por edhe t'i emërojnë rrënjët dhe elementet e përbashkëta të judaizmit dhe të religjioneve tjera.

2.15. Bazueshmëria etike e judaizmit

Përmbajtjet për bazueshmërinë etike të mësimit judit duhet që nxënësve t'ju tregojnë për faktin se vlerat etike do t'ju mundësojnë t'i njohin dhe pranojnë dallimet ndërmjet njerëzve që rrjedhin nga origjina, nacionalitetit, feja etj. Gjithashtu këto përmbajtje do t'i njohin me bazat e rregullave judaiste për mbajtjen e raporteve të mira në familje dhe në bashkësi dhe se në bashkësi të gjithë ata duhet të angazhohen për atë që duhet ta bëjnë në jetën e përditshme.

2.16. Morali në judaizëm

Përmbajtjet e orientuara kah morali në judaizëm do të mundësojnë që nxënësit ta njohin dhe kuptojnë se ekzistojnë mënyra të ndryshme për t'ju ndihmuar njerëzve, por jo vetëm t'ju ndihmohet por edhe të bëhen vepra të mira. Në këtë kontekst përmes përmbajtjeve tjera nga kjo temë nxënësit ta dinë se pse duhet t'ju

shmangen veprimeve të këqija dhe të formojnë qëndrimin e vet ndaj sjelljes së keqe, por edhe të njohin se dhjetë urdhra janë për të gjithë njerëzit pa dallim të fesë, racës, kombësisë etj.

Organizimi i mësimit

